



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtruesi ..... nga ....., Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me datë 14.12.2020, morri

### VENDIM

Denoncimi për korrupsion nr. 12-5849/1 me datë 31.12.2019, dorëzuar deri tek KSHPK nga parashtruesi ..... nga ....., **RREFUZOHET**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka kompetenca për të vepruar për lëndës nr. 12-5849 nga viti 2019, e formuar pas denoncimit 12-5849/1 me datë 31.12.2019.

Lënda me numër 12-5849 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK me sqarimin.

Vendimi i KSHPK me sqarimin – në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

### Sqarim

Lënda me numër 12-5849 nga viti 2019 formuar pas denoncimit nr. 12-5849/1 me datë 31.12.2019. dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga ana e parashtruesit ..... nga .....

Në denoncimin e dorëzuar tregohen akuza për pakënaqësi nga veprimi i avokatit dhe përmbaruesi nga Velesi në lidhje me aktgjykime të marrura nga Gjykata themelore në Veles në procedurë qytetare, dhe në lidhje me shumën nga llogaria e bërë e kamatës e cila duhet të paguhet në procedurat si dëmshpërblim në të holla, si dhe akuza për pakënaqësi nga puna dhe sjellja e gjyqtarëve dhe për keqpërdorim të detyrës së tyre gjyqtare gjatë marrjes së aktvendimeve dhe vendimeve.

Në rastin konkret bëhet fjalë për procedura qytetare udhëhequr pran Gjykatës themelore në Veles për të cilat më shumë herë është vendosur dhe marrë verdikte në periudhën prej viteve 2005 deri 2014, në bazë të padive të dorëzuara nga ana e ish të punësuarit në ndërmarrjen ..... industria metalit ”..... ” në falimentim, Veles. Paditë janë dorëzuar në baza të ndryshme: për shfuqizim të vendimit për ndërprerje të kontratës së punës dhe kërkesë për kthim në punë; caktimit të masës falimentuese dhe pagesë të kontributeve, caktimit të llogaritjeve të pasaktq për pagesq të shpenzimeve për procedurën falimentuese, rroga dhe kontribute për rrogë të të punësuarve në ndërmarrjen e theksuar. Në lidhje me verdiktet nga ana e Gjykatës është dhënë obligim për debitorin për pagesë të shpenzimeve, të cilët kanë të bëjnë me shpërblime për përfaqësim të të paditurit të dytë nga ana e avokatit: përfaqësim në diskutimet e mbajtura/ndëgjime, përbërje e autorizimit dhe përbërje të arkës, dhe përshkak të kësaj nga ana e debitorit nuk është vepruar për obligimit nga ana e Gjykatës, kreditorët e procedurës dorëzuan kërkesë për përbarim deri te përmbaruesi, me të cilën kërkojnë të merret

veprim për pagesë të obligura (me dhunë) të borxhit kryesor (bazë) me kamatën si dhe të bëjnë kompenzim në harxhimet për përmbarim, me regjistrim, vlerësim, plaçkitje dhe shitje të lëndëve të lëvizshme të cilat do të gjenden në shtëpitë dhe shitoret e debitorit, kurse mjetet e fituara nga shitja e tyre nëpërmjet llogarisë së përmbaruesit të transferohen në llogari të kreditorit në procedurën ose të përfaqësuesit të tij.

Nga ana e parashtruesit të denoncimit në lidhje me akuzat e lëndës kundër përmbaruesit të përmendur janë dorëzuar padi për kundërvajtje deri në Prokurorinë themelore publike në Veles, me të cilën për padinë për kundërvajtje është marrë Vendim me datë 28.04.2017 me të cilën e njëjta rrefuzohet sepse vepra e denoncuar nuk është kundërvajtje me të cilën mund të paditet me detyrë zyrtare. Në sqarimin e prokurorit publik është theksuar se veprimi i denoncuarit si përmbarues ka qenë në kuadër të autorizimeve ligjore të tij dhe gjatë vendimmarrjes prokuroia vërtetoi se në aktivitetet e përmbaruesit nuk ka elemente ligjore të veprës për kundërvajtje dhe jo për keqpërdorim të detyrës së tij zyrtare dhe autorizimit si përmbarues, nuk ka marrë për vete ose vlerë tjetër të pronës dhe nuk ka shkaktuar dëmë. Në bazë të Vendimit të theksuar veproai edhe Prokuroria e lartë publike në Shkup, me çka është vërtetuar se nga ana e Prokurorisë së lartë është vepruar në përputhje me ligjin dhe në kuadër të autorizimeve ligjore të tij dhe integritetit.

Pas rishikimi të denoncimit, KSHPK i merr parasyshtë akuzat nga parashtruesi dhe konstaton se denoncimi ka të bëjë me aktivitetine në procedurë qytetare të udhëhequra pran organit kompetent gjyqsor me çka është dorëzuar kallëzim penal deri në Prokurorinë themelore publike kompetente e cila ka vepruar për të njëjtën dhe ka marrë vendim përfundimtar të prokurorisë për rrefuzim të kallëzimit penal. Gjithashtu, KSHPK konstaton se nga ana e parashtruesit të denoncimit janë shfrytëzuar mjete juridike të ofruara në lidhje me rastin e lëndës dhe të gjithë organet kompetente deri tek të cilët është drejtuar kanë vepruar ose veprojnë në kuadër të kompetencave të veta. Për arsye që për këtë rast më shumë herë është vendosur në procedurë gjysqore është se është vepruar edhe nga organe tjetër kompetent (PTHP Veles, Prokuroria e lartë publike në Shkup dhe Prokuroria publike e RMV), Komisioni shtetëror nuk ka kompetenca ligjore për veprim të rastit të lëndës, denoncimi i dorëzuar rrefuzohet dhe lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pas parasyshtë të theksuarën më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

**Është vendosur me datë 14. Dhjetor 2020 me numër 12-2092/3**

Dorëzuar deri te: arkiva dhe parashtruesi  
Pas përfundimit të KSHPK  
Punoi: J. C., këshilltarë  
Miratoi: K. H., anëtar i KSHPK

KOMISIONI SHTETËRORE PËR  
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT  
Kyetar: Biljana Ivanovska